



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 86, DATË 08.10.2020

PËR

PËRCAKTIMIN E FREKUENCAVE PËR SHËRBIMIN E TRANSMETIMIT
AUDIO ANALOGE DHE ÇELJEN E GARËS PËR DHËNIEN E LICENCËS TË
TRANSMETIMIT AUDIO ANALOGE

Në mbështetje të nenit 19, pika 16, nenit 59 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënie e licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin nr. 153, datë 18.07.2016 të AMA-s, të ndryshuar Autoriteti i Mediave Audiovizive,

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e frekuencave për shërbimin e transmetimit audio analoge në zonat e mëposhtme:

Nr.	Zona e ofrimit të shërbimit
1.	Qarqet Tiranë, Durrës
2.	Qarqet Tiranë, Durrës
3.	Qarqet Elbasan, Fier dhe Vlorë
4.	Bashkitë Elbasan, Cërrik, Belsh dhe Bashkia Gramsh

2. Çeljen e garës për dhënie e licencës së transmetimit audio analoge, për zonat e mëposhtme:

Nr.	Zona e ofrimit të shërbimit	Përcaktimi i operatorit	Pika transmetuese	Frekuenca (MHz)
1.	Qarqet Tiranë, Durrës	Audio Analoge Rajonale	Fushë Dajt	92.3
2.	Qarqet Tiranë, Durrës	Audio Analoge Rajonale	Fushë Dajt	92.6
3.	Qarqet Elbasan		Petresh	87.9
			Librazhd	89.6
			Gramsh	93

	Fier, dhe Vlorë	Audio Analoge Rajonale	Prenjas	88.4
			Ardenicë	97.9
			Ligovun	95.1
			Ballsh	99.4
			Zvërnec	91.6
			Llogara	95.3
			Treblovë	96.3
			Himarë	94.9
			Sopot	105.1
			Mile	95.5
4.	Bashkitë Elbasan, Cërrik, Belsh Gramsh	Audio Analoge Lokale	Petresh	96.3
			Gramsh	88.6

3. Miratimin e dokumentacionit të dhënies së licencës private të transmetimit audio analoge, bashkëlidhur këtij vendimi, të përbërë nga: a. licenca e shërbimit të programi audio dhe b. licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit analog.
4. Shpalljen në mënyrë publike të çeljes së procedurës për dhënien e licencës së transmetimit audio.
5. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DOKUMENTACIONI I KËRKUAR PËR LICENCË TRANSMETIMI AUDIO ANALOGE

Bazuar në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregulloren “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 153, datë 18.07.2016, të ndryshuar, licencimi i transmetimit audio bëhet nga AMA nëpërmjet konkurrimit të aplikimeve.

AMA, pasi studion spektrin e frekuencave të destinuara për transmetime audio çel garën për dhënien e licencës përkatëse, në të cilën përcakton hapësirën e mbulimit të licencës për të cilën mund të aplikohet.

Në zbatim të rregullores së sipërcituar, më poshtë paraqitet dokumentacioni i kërkuar për pajisjen me licencë transmetimi audio analoge ose për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit.

Dokumentacioni juridik

1. Regjistrimi në QKR me gjithë ndryshime (nëse ka), forma ligjore, emërtimi i subjektit, lista e aksionerëve me kuotat respektive; Në rastin kur njëri nga ortakët e subjektit aplikues është person juridik duhet të paraqitet lista e ortakëve të tij (në rastin e licencave lokale apo rajonale e transmetimit audio u jepet personave juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, me objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive).
2. Deklaratë noteriale të secilit prej aksionarëve të subjektit aplikues, lidhur me aksionet/kuotat e zotëruara prej tyre në shoqëri të tjera audio ose audiovizive;
3. Vërtetim i gjendjes gjyqësore të aksionarëve të subjektit;
4. Adresa, nr. tel, fax, e_d. mail;
5. Personi përfaqësues.

Dokumentacioni teknik:

1. Objekti dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit përfshirë mbulimin dhe interferencat;
2. Projekti dhe preventivi i rrjetit (a. skema e organizimit, b. projektet teknike të studiove; c. projektet teknike të pikave të transmetimit, d. karakteristikat teknike të pajisjeve transmetuese, të dhëna per sistemin RDS) hartuar nga një inxhinier elektronik i pajisur me diplomën përkatëse (Master Shkencor);
1. Projekti dhe preventivi i rrjetit, të shërbimeve fikse, frekuencat e të cilave administrohen nga AKEP;
2. Afati i propozuar i përfundimit të rrjetit.

Dokumentacioni ekonomik:

1. Të dhëna për kapitalin e deklaruar dhe të nënshkruar të shoqërisë, i cili duhet të jetë i vërtetuar ose në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ose nga një ekspert kontabël i miratuar/autorizuar; (për licencat rajonale kapitali i kërkuar është në masën 2,500,000 lekë, ndërsa për licencat lokale kapitali i kërkuar është në masën 1,000,000 lekë)
2. Parashikimi për shpenzimet dhe të ardhurat për periudhën e vlefshmërisë së licencës duke përcaktuar llojet e të ardhurave (reklama, të ardhura nga të tretët, të ardhurat nga shërbimi etj), shpenzimet fikse, të ndryshueshme, detyrimet tatimore, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, origjinën dhe vlerën e investimeve që parashikohen të kryhen gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës);
3. Garancia bankare që vërteton se aplikanti ka ngurtësuar shumën prej 10% të vlerës së kapitalit financiar të kërkuar, për një periudhë deri në 6 muaj, duke filluar nga data e paraqitjes së aplikimit;
4. Lista e administratorëve.

Dokumentacioni për programet

1. Përmbajtja e programeve që do të transmetohen të jetë në përputhje me parimet themelore të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar dhe kërkesat e Kodit të Transmetimit të AMA-s;
2. Struktura programore e propozuar duhet të përmbajë të dhëna dhe raporte që, në tërësinë e tyre shprehin qartë pluralizmin dhe paanësinë e informacionit;
3. Të dhëna statistikore për programet audio të katalogut të shërbimit programor të përgjithshëm dhe tematike (Informacion, kulturë, art, argëtim, zbatimje, dramatizim, sport, emisione për fëmijë, reklamë, etj.)
4. Të dhëna për kohëzgjatjen e programeve;
5. Programi javor i transmetimit;
6. Grila e strukturës programore;
7. Përshkrim i shkurtër i përmbajtjes së programeve kryesore të prodhuara vetë që garanton cilësinë e informacionit, promovimin e gjuhës e të kulturës kombëtare, larminë e programeve për fëmijë e të rinj, si dhe çështje specifike të traditës e zhvillimeve rajonale e lokale.

Dokumentacioni për të drejtën e transmetimit

1. Dokumentacioni që vërteton të drejtën e transmetimit të programeve (kontratë për kalimin e të drejtave të transmetimit si shitje, dhurimi ose shkëmbimi).

Dokumentacioni mbi aspektin organizativ

1. Të dhëna mbi numrin e punonjësve që parashikon të punësojë;
2. Deklarata për vërtetësinë e të dhënave të paraqitura;
3. Informacion mbi strukturën e pronësisë së kompanisë dhe aksionerëve të saj;
4. Organizimi dhe drejtimi i shoqërisë, lista dhe CV-të e anëtarëve të Bordit.

Shënim: Dokumentacioni i aplikimit që merret në institucionet shtetërore, duhet të jetë marrë jo më vonë se 30 ditë përpara datës së aplikimit. Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme është kusht skualifikues. AMA gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit të aplikimit për dhënien e licencës së transmetimit audio, kërkon

informacion për subjektet aplikues nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave.

PLANI FREKUENCOR PËR LICENCË TRANSMETIMI AUDIO ANALOGE

Nr.	Zona e ofrimit të shërbimit	Përcaktimi i operatorit	Pika transmetuese	Frekuenca (MHz)
1.	Qarqet Tiranë, Durrës	Audio Analoge Rajonale	Fushë Dajt	92.3
2.	Qarqet Tiranë Durrës	Audio Analoge Rajonale	Fushë Dajt	92.6
3.	Qarqet Fier, Elbasan dhe Vlorë	Audio Analoge Rajonale	Petresh	87.9
			Librazhd	89.6
			Gramsh	93
			Prrenjas	88.4
			Ardenicë	97.9
			Ligovun	95.1
			Ballsh	99.4
			Zvërnec	91.6
			Llogara	95.3
			Treblovë	96.3
			Himarë	94.9
			Sopot	105.1
Mile	95.5			
4.	Bashkitë Elbasan, Cërrik, Belsh Gramsh	Audio Analoge Lokale	Petresh	96.3
			Gramsh	88.6

PAGESA E TARIFAVE

Në zbatim të gërmës “a”, “b”, dhe “c” të nenit 26 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më poshtë po paraqesim pagesat që do të kryhen pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, subjektet e interesuara që aplikojnë për licencë private transmetimi audio, si:

1. Miratimi i pagesave për blerje dokumentacioni, pagesa për përpunimin e kërkesave për licencë dhe pagesa për marrje licence është bërë me vendimin e AMA-s, nr. 220, datë 01.12.2017 “Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”.

a. Tarifa për blerjen e dokumentacionit të licencimit

1,000 lekë

Kjo tarifë kryhet pranë AMA-s, në momentin e marrjes të dokumentacionit përkatës.

b. Pagesë për përpunimin e kërkesave për licencë 50,000 lekë

Pagesat do të kryhen në llogaritë bankare të AMA-s, pas dorëzimit të aplikimit pranë AMA-s, por jo më vonë se data e hapjes të aplikimit.

c. Pagesa për marrje licence 15,000 lekë

Pagesat do të kryhen në llogaritë bankare të AMA-s, pas miratimit të dhënies së licencës nga AMA.

2. Masa e pagesës vjetore për licencë do të përcaktohet sipas pikës 1.3.2. të vendimit të AMA-s nr. 220, datë 01.12.2017 “Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”

Pagesa për marrjen e licencës kryhet menjëhere pas miratimit të vendimit të licencimit, ndërsa pagesa vjetore për licencë kryhet brenda tremujorit të parë të vitit kalendarik. Në rastin kur pagesa kryhet pas kalimit të këtij afati, aplikohet një kamatë vonese në masën 0.1% të vlerës së pagesës vjetore për çdo ditë vonese por jo më shumë se 30% e vlerës së detyrimit financiar.

Pagesat do të kryhen në llogaritë bankare të AMA-s, në adresën:

Autoriteti i Mediave Audiovizive - AMA

1. Banka Credins

Nr. Llogarisë 458017

IBAN: AL12 2121 1157 0000 0000 00458017

2. Banka Raiffeisen

Nr. Llogarisë 0100007029

IBAN: AL38 2021 1013 0000 0001 0000 7029

3. Banka BKT

Nr. Llogarisë 402947044

IBAN: AL73 2051 1021 9470 44CL PBCL ALLA

Përveç pagesave të sipërpërmendura, pranë AMA-s, do të kryhet dhe pagesa e tarifës për shërbimet radiotelevizive, në zbatim të ligjit nr. 9975, date 19.05.2008 “Për taksat kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, e cila llogaritet nga AMA, mbi bazën e numrit të transmetuesve të vendosur nga operatorët RTV, fuqisë së rrezatimit të çdo transmetuesi si dhe koeficientin e përlllogaritur sipas vendndodhjes së transmetuesit, tarifatat si më poshtë:

TARIFAT VJETORE PËR SHËRBIMET E TRANSMETIMEVE RADIO TELEVIZIVE

Për transmetuesit ose përsëritësit televizivë analogë tokësorë, radio FM tokësore, radio AM të operatorëve privatë radio e televizivë, kombëtarë e vendorë:

1. Për çdo transmetues ose përsëritës televiziv analogjik tokësor
 - a) me fuqi të rrezatuar deri në 10 W 1500 lekë në vit;
 - b) me fuqi të rrezatuar deri në 100 W 6000 lekë në vit;
 - c) me fuqi të rrezatuar deri në 1000 W 24 000 lekë në vit;
 - ç) me fuqi të rrezatuar deri në 10 000 W 48 000 lekë në vit;
 - d) me fuqi të rrezatuar mbi 10 000 W 60 000 lekë në vit.
2. Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.ç, 1.d, 2b, 2c, 2ç, 2d, mbulon mbi gjysmën e qytetit të Tiranës, atëherë tarifa e llogaritur në këto pika shumëzohet me koeficientin 5.
3. Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.ç, 1.d, 2b, 2c, 2ç, 2d, mbulon mbi gjysmën e një qyteti me popullsi mbi 100 000 banorë, atëherë tarifa e llogaritur mbi këto pika shumëzohet me koeficientin 2.
4. Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.ç, 1.d, 2b, 2c, 2ç, 2d, mbulon mbi gjysmën e një qyteti me popullsi 50 000 deri në 100 000 banorë, atëherë tarifa e llogaritur në këto pika shumëzohet me koeficientin 1.5.
5. Në qoftë se transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.ç, 1.d, 2b, 2c, 2ç, 2d, mbulojnë dy ose më shumë qytete të cituara në pikat 3, 4, 5, atëherë tarifa e llogaritur në këto pika shumëzohet vetëm një herë me koeficientin më të lartë.
6. Për çdo transmetues AM 200 000 lekë në vit.

Gjithashtu, pagesa për tarifën e shërbimeve radiotelevizive do të kryhen në llogaritë bankare të AMA-s, në adresën:

Autoriteti i Mediave Audiovizive - AMA

4. Banka Credins

Nr. Llogarisë 458017

IBAN: AL12 2121 1157 0000 0000 00458017

5. Banka Raiffeisen

Nr. Llogarisë 0100007029

IBAN: AL38 2021 1013 0000 0001 0000 7029

6. Banka BKT

Nr. Llogarisë 402947044

IBAN: AL73 2051 1021 9470 44CL PBCL ALLA